

## TAKIMI I PARË 2026 - KOMITETI SEKTORIAL I ENERGJISË

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Energjisë u mbajt më datë **03.03.2026**.

Takimi u hap nga Drejtoresha e Përgjithshme e AKAFPK-së, e cila u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe falënderoi anëtarët për kontributin në sektorin e energjisë dhe gatishmërinë e treguar për të bashkëpunuar në funksion të Komitetit Sektorial. Gjatë fjalës hyrëse, u vu në dukje rëndësia e Komitetit Sektorial, si një mekanizëm që lidh arsimin dhe formimin profesional me kërkesat e tregut të punës dhe rolin strategjik të sektorit të energjisë në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, u theksua nevoja për përfshirjen e të gjithë aktorëve për zhvillimin e qëndrueshëm të kualifikimeve profesionale.

Në vijim, u prezantua roli dhe misioni i AKAFPK-së, sigurimi i cilësisë përmes proceseve të vetëvlerësimit dhe akreditimit, rëndësia e bashkëpunimit në zhvillimin e kurrikulave dhe përputhjen e aftësive me kërkesat e tregut të punës. Më pas, anëtarët prezantuan institucionet që përfaqësonin, përvojën dhe pritshmëritë e tyre për angazhimin në Komitet.

Në pjesën e dytë të takimit, u paraqit kuadri ligjor, objektivat, funksionet dhe rezultatet e pritshme të veprimtarisë së Komiteteve Sektoriale, si dhe roli i Sekretariatit Teknik në mbështetjen e veprimtarisë së tyre. U prezantua rregullorja e funksionimit të Komitetit, duke u shpjeguar parimet, organizimi i mbledhjeve, baza ligjore e shpërblimit dhe rastet e zëvendësimit të anëtarëve. U theksua gjithashtu, rëndësia e pjesëmarrjes aktive të anëtarëve në mbledhjet e Komitetit.

Në vijim, u prezantua Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK), duke u shpjeguar struktura e saj, funksioni në klasifikimin e kualifikimeve dhe lehtësimi i lëvizjes ndërmjet tyre. U nënvizua rëndësia e referencimit me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), e finalizuar në vitin 2021, që mundësoi njohjen e ndërsjellët të kualifikimeve profesionale. Gjithashtu, u vu në pah roli i KSHK-së si bazë për ndërtimin e kualifikimeve në të gjitha format e të nxënit dhe rëndësia e certifikimit të përvojave jashtë sistemit formal.

Në përfundim, u zhvillua procesi për zgjedhjen e kryetarit të Komitetit. Gjatë diskutimeve u evidentua rëndësia e këtij roli dhe nevoja për një përfaqësim sa më të gjerë të sektorit. Anëtarët pas diskutimeve, propozuan kandidatin, i cili u miratua unanimisht me votim.

Në pjesën e fundit të takimit u diskutua dhe u dakordësua mbi temat kryesore të mbledhjes së radhës dhe angazhimin e anëtarëve për bashkëpunim të mëtejshëm.